



Kaçanik, 30/01/2026

Duke u bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Kaçanikut Nr. 01-104/02-2019/26 datë 23.01.2026, me Rregulloren MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe Rregulloren Komunale nr. 06/2016 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, shpall:

Data	30.01.2026	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	09-104/02-	Numri	2563/26
		Shtojcë	

THIRRJE PUBLIKE

Për mbështetje financiare të projekteve/programmeve të OJQ-ve në fushën e Rinisë dhe Sportit për vitin 2026

1. Qëllimi i thirrjes

Komuna e Kaçanikut / Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit fton të gjitha **organizatat joqeveritare (OJQ)** të regjistruara në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në Komunën e Kaçanikut dhe kanë program pune të fokusuar në **fushën e Rinisë dhe Sportit**, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet e tyre sipas kësaj thirrjeje publike.

2. Fushat prioritare

OJQ-të mund të aplikojnë me projekte/programme që kontribuojnë në promovimin e **Rinisë dhe Sportit**.

3. Aktivitetet e mbështetura

OJQ-të mund të aplikojnë me projekte që kontribuojnë në promovimin e Rinisë dhe Sportit përmes aktiviteteve si më poshtë:

NË FUSHËN E RINISË DHE SPORTIT:

- Mbështetja dhe fuqizimi i organizatave rinore për zhvillimin e aktiviteteve me të rinjë duke u mbështetur në plan programin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2026;
- Përkrahja e klubeve sportive publike që funksionojnë në Komunën e Kaçanikut të regjistruara në federatat përkatëse e që marrin pjesë në gara zyrtare në vitin 2026..
- Sporti i femrave - zhvillimi dhe pjesëmarrja aktive e femrave në sport, përmes përkrahjes së klubeve, dhe aktiviteteve sportive për vajza dhe gra.
- Sporti shkollor- inkurajohet zhvillimi i sportit në shkolla, organizimi i garave shkollore dhe bashkëpunimi me institucionet arsimore për promovimin e aktivitetit fizik.
- Sporti rekreativ dhe sporti për të gjithë - mbështeten aktivitetet sportive rekreative që synojnë përfshirjen e të gjitha moshave dhe kategorive shoqërore në sport dhe aktivitet fizik.
- Sporti i të rinjve dhe identifikimi i talentëve -përkrahen programet për zhvillimin e sportit të të rinjve dhe identifikimin e talentëve sportive, me qëllim avancimin e tyre drejt niveleve më të larta të garave.
- Shëndeti dhe siguria e sportistëve,-inkurajohen aktivitetet që kontribuojnë në ruajtjen e shëndetit të sportistëve, parandalimin e lëndimeve dhe sigurimin e kushteve të sigurta gjatë stërvitjeve dhe garave.
- Zhvillimi dhe menaxhimi i klubeve sportive -mbështetet forcimi i kapaciteteve organizative dhe menaxheriale të klubeve sportive për funksionim të qëndrueshëm dhe profesional.

4. Buxheti i thirrjes për Rini dhe Sport

Vlera totale e planifikuar e thirrjes publike është **82,000.00 €**

4.1 RINI

Mbështetje në realizimin e aktiviteteve rinore bazuar në planprogramin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2026, i cili përfshinë aktivitete në organizimin :

- Java e Rinisë
- Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve;
- 11 Qershori – Dita e Çlirimit të Kaçanikut;
- Festave të Nëntorit;
- Dita Botërore e Sportit dhe Ambientit;
- Java Evropiane e Sportit;
- 10 Gushti – Dita e Dëshmorëve.
- Dita ndërkombëtare e Tokës
- Dita ndërkombëtare e Librit
- Dita ndërkombëtare e muzeve
- Dita ndërkombëtare e trashëgimisë kulturore

4.2 SPORT

4.2.1 Përkrahja për klubet sportive të regjistruara në federatat përkatëse e që marrin pjesë në gara sportive zyrtare për vitin 2026.

Subvencionimi përfshin:

- Shpenzimet e transportit, akomodimit dhe ushqimit;
- Pagesën e kotizimeve, taksave, regjistrimeve dhe tarifave garuese;
- Pajisje dhe rekuizita sportive;
- Shpenzime të tjera të drejtpërdrejta që lidhen me garat sportive.

4.2.2 Sporti i femrave - mbështeten klubet dhe ekipet e femrave përmes subvencioneve, organizimit të garave, aktiviteteve promovuese dhe krijimit të kushteve të barabarta për stërvitje dhe gara.

4.2.3 Sporti shkollor – mbështeten organizimi i garave shkollore, turneve komunale dhe bashkëpunimit me institucionet arsimore e komunale për përfshirjen e nxënësve në aktivitete sportive.

4.2.6 Sporti rekreativ dhe sporti për të gjithë - mbështeten organizimi i aktiviteteve rekreative, ngjarjeve sportive masive dhe programeve që nxisin pjesëmarrjen e qytetarëve të të gjitha moshave.

4.2.7 Sporti i të rinjve dhe identifikimi i talenteve - mbështeten programe zhvillimore për të rinjtë, turne seleksionues, bashkëpunim me klubet dhe shkollat për identifikimin dhe avancimin e talenteve .

4.2.8 Shëndeti dhe siguria e sportistëve – mbështeten aktivitete përmes zbatimit të masave parandaluese, edukimit për shëndetin sportiv dhe respektimit të standardeve të sigurisë gjatë stërvitjeve dhe garave, prezencës së mjekëve në aktrivitetet sportive .

4.2.9 Zhvillimi dhe menaxhimi i klubeve sportive – të realizohet përmes përkrahjes financiare, trajnimeve menaxheriale dhe forcimit të kapaciteteve organizative të klubeve sportive.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është **15 ditë pune** dhe përfundon me datë **19.02.2026**.

- OJQ-të mund të aplikojnë me projekte në kuadër të kësaj thirrjeje ;
- Shuma minimale e mbështetjes financiare për OJQ-të që mund të alokohet për një projekt është **500 €**, ndërsa shuma maksimale është **25,000 €**;
- Periudha e zbatimit të projektit është deri në përfundimin e vitit **2026**;
- Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe që veprojnë në Komunën e Kaçanikut;
- OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e Rinisë dhe Sportit;
- OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente, sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit;
- OJQ-të duhet të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare publike;
- Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-ja duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur lidhur me pagesën e kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

5. Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilët, së bashku me **Udhëzimet për Aplikantët**, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Kaçanikut:

☞ <http://kk.rks-gov.net/kacanic> (Kliko: **SHPALLJET – APLIKACIONET**)

6. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: ✉ lulzim.n.krasniqi@rks-gov.net

Kërkesës së aplikimit duhet t'i bashkëngjiten edhe dokumentet:

- Certifikata e numrit të regjistrimit dhe numrit fiskal të organizatës;
- Vërtetim nga DKRS në Kaçanik për regjistrimin e klubit dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për vitin paraprak (vërtetim i lëshuar në vitin 2026);
- Vërtetimi i regjistrimit pranë Federatës përkatëse (vetëm për klubet sportive);
- Letërnjoftimi i personit (aplikantit) që përfaqëson organizatën dhe i menaxherit të projektit;
- Xhirrollogaria dhe dëshmia e bankës në emër të organizatës;
- Dëshmi se organizata nuk ka obligime ndaj ATK-së.

Dokumentacioni që shkarkohet nga ueb-faqja e Komunës së Kaçanikut:

1. Formulari i aplikacionit për projekt/program (Formulari F9);
2. Formulari i propozim-buxhetit (Formulari F10);
3. Formulari i deklaratës për mungesën e financimit të dyfishtë (Formulari F11);
4. Formulari i deklarimit të programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike (Formulari F13);
5. Formulari i deklaratës së partneritetit, nëse është e aplikueshme (Formulari F12);
6. Deklaratë e aktiviteteve të kontraktorit të përmendura në përshkrimin e aktiviteteve të projektit, që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin e projektit, nëse është e aplikueshme (Formulari F14);
7. Dokumentacioni i aplikimit duhet të printohet, të nënshkruhet nga menaxheri i projektit dhe përfaqësuesi i OJQ-së dhe të vuloset. Ky dokumentacion i dorëzuar në tërësi skanohet dhe dorëzohet së bashku me të gjitha dokumentet përcjellëse në CD ose USB (obligative).

Komuna e Kaçanikut do të formojë një komision profesional për vlerësimin e projekteve dhe rezultatet do të jenë publike për secilën OJQ aplikuese, të detajuara sipas Rregullores MF-NR-04-2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe Rregullores Komunale Nr. 06/2016 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

Data e aplikimit është nga 30.01.2026 deri më 19.02.2026.

Dorëzimi i aplikacioneve:

Objekti i Komunës së Kaçanikut, Zyra Pritëse (Sporteli nr. 5).

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimit, dhënies së fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve, si dhe kalendari tregues i zbatimit të ftesës janë të detajuara në Udhëzimet për Aplikuesit (ju lutemi konsultoni Udhëzuesin për aplikim I publikuar në ueb-faqen e komunës). Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe që i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të ftesës publike.

Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Lulzim Krasniqi – Drejtor

